

**VENDIM**  
**Nr. 836, datë 3.12.2014**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME  
TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE  
SHOQËRISË “CALZATURIFICIO ADELCHI” SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR  
PASURINË “AMBIENTE NË ISH-UZINËN E FERMENTIMIT, SHKODËR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “Calzaturificio Adelchi” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Ambiente në ish - Uzinën e Fermentimit, Shkodër”, me sipërfaqe të përgjithshme 8 667 (tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) m<sup>2</sup>.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**